

**KONTRATE SHITJE-BLERJE TE KUOTAVE  
TE SHOQERISE  
TRADE AND FINANCE ALBANIA SH.P.K.**

**Baza ligjore**

*Liqji NR. 9901, "PËR TREGTARËT DHE SHOQËRITË TREGTARE"*  
*Kodit Civil perkatesisht -Nenet 6, 705-750*

Sot, me date 12/09/2022 u lidh kjo kontrate e shitjes se kuotave te shoqerise **TRADE AND FINANCE ALBANIA** sh.p.k. me NIPT **L81930002H** me seli ne Rruga Ibrahim Tukiqi, Pallati 14, Zyra 17, Tirane 1001, Shqiperi; Midis palëve:

1. Znj. Malgorzata Dowgielewicz, person fizik, shtetase polake, lindur më 07/03/1971 në Sepopol , Poloni, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar ,identifikuar nga Pashaporta meNr. EG9145807 dhe me Nr. Personal 71030705243 nga këtu e më poshtë referuar si "**Shitësi**".

**DHE**

2. Z. Mario Di Iorio, person fizik, shtetas italian, lindur më 03/05/1971 në Frosolone, Itali, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar,identifikuar nga karta e identitetit me Nr. AU5154043 dhe me Nr. Personal AU5154043 nga këtu e më poshtë referuar si "**Blerësi**".

**TË DHENA PARAPRAKE**

Shitësi: **Znj. Malgorzata Dowgielewicz** ka në pronësi pasurine e 100 % (njëqind perqind) te kuotave te shoqërisë TRADE AND FINANCE ALBANIA sh.p.k me Nipt L81930002H themeluar me datë 27/06/2018, me seli në Rruga Ibrahim Tukiqi, Pallati 14, Zyra 17, Tirane 1001, Shqiperi.

**NENI 1**

**Objekti**

- 1.1 Objekti i kësaj kontrate është shitja i 50% (pesëdhjetë përqind) të kuotave te shoqërisë TRADE AND FINANCE ALBANIA Sh.p.k, e barazvlefshme kjo me vlerën nominale prej 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë nga Shitësi ne favor te Blerësit, kundrejt vleres se përcaktuar ne Nenin 2 te kësaj kontrate.

## **NENI 2**

### **Vlera**

2.1. Shitësi ia shet 50% (pesëdhjetë përqind) të kuotave të shoqërisë, nga shitësi në favor të blerësit me vlerën nominale 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

## **NENI 3**

### **Te drejta dhe detyrime ndaj palëve**

3.1. Shitësi garanton Blerësin për titullin e pronësisë objekt i kësaj kontrate dhe për saktësinë e dokumentacionit zyrtar të saj, në të kundërt mban përgjegjësi civile për demin e shkaktuar.

3.2. Shitësi është i detyruar t'i dorëzojë pasurinë objekt kontrate në masën 50% (pesëdhjetë përqind) blerësit, që nga momenti i hyrjes në fuqi të kësaj kontrate.

3.3. Ky dokument hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit të tij, dhe rrjedhimisht do të depozitohet pranë QKB-se për tu bërë i vlefshëm.

3.4. Shitësi është i detyruar t'i dorëzojë pasurinë objekt kontrate. Blerësit të shkarkuar nga çdo e drejtë apo pretendim i të tjerëve.

3.5. Blerësi ka të drejtë të njoftojë brenda 5 (pese) ditëve Shitësin në rast se të tjerët ngrenë pretendime pronësie mbi sendin objekt i kësaj kontrate.

## **NENI 4**

### **Kalimi i pronësisë**

4.1. Me nënshkrimin e kësaj kontrate Blerësi bëhet pronar i 50% (pesëdhjetë përqind) të kuotave të shoqërisë "TRADE AND FINANCE ALBANIA" Sh.p.k.

## **NENI 5**

### **Te ndryshme**

5.1. Palët do të kërkojnë ekzekutimin e kësaj kontrate pranë sporteve të Qendrës Kombëtare të Biznesit

5.2. Palët do të përpiqen të zgjidhin me mirëkuptim çdo mosmarrveshje që mund të lindë për shkak të ekzekutimit të kësaj kontrate. Në rast se mosmarrveshjet nuk zgjidhen me mirëkuptim, kompetente për zgjidhjen e tyre është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kontrata u hartua në 3 kopje në gjuhën shqipe, palët pasi e kanë lexuar nëpërmjet personit të autorizuar i cili është nominuar me autorizimin e administratorit të shoqërisë me anë të dokumentit të autorizimit i cili i bashkangjitet kësaj kontrate, kuptuar dhe pranuar përmbajtjen e aktit, e nënshkruajnë atë me vullnet të plotë pa vërejtje duke vënë emrin, mbiemrin dhe firmën.

**SHITESI**

**Znj. Malgorzata Dowgielewicz**

MALGORZATA DOWGIELEWICZ  
Malgorzata Dowgielewicz

**BLERESI**

**Z. Mario Di Iorio**

DI IORIO MARIO  
Z. Mario Di Iorio